

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-03-66-ES

Data: 9 janar 2013

Originali: anglisht

KRYETARI I TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR

Para: Gjykatësit Theodor Meron, Kryetar

Sekretar: Z. John Hocking

Vendim: 9 janar 2013

PROKURORI

k.

HARADIN BALËS

PUBLIK

**VERSIONI I REDAKTUAR PUBLIK I VENDIMIT TË 28 QERSHORIT 2012 TË
KRYETARIT MBI LIRIMIN E PARAKOHSHËM TË HARADIN BALËS**

Zyrës së Prokurorit
Z. Serge Brammertz

Qeverisë së Republikës Franceze:

Avokatëve të të Akuzuarit:
Z. Gregor Guy-Smith
Z. Gentian Zyberi

1. Unë, Theodor Meron, Kryetar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) kam marrë “Mocion për Lirim të Parakohshëm në emër të z. Haradin Bala” (“Kërkesë”), paraqitur nga avokati i z. Haradin Bala (“Bala”) më 8 nëntor 2011, në bazë të Nenit 28 të Statutit të Tribunalit (“Statuti”), Rregullave 124 dhe 125 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”) dhe paragrafit 2 të Direktivës mbi Kërkesat për Falje, Ulje të Dënimit dhe Lirim të Parakohshëm të Personave të Dënuar nga Tribunali Ndërkombëtar (“Direktiva”).¹

I. HISTORIA PROCEDURALE

2. Aktakuza fillestare kundër Balës u paraqit më 27 janar 2003,² dhe më pas u ndryshua dy herë, versioni i fundit i ndryshuar u paraqit më 2004.³ Bala u akuzua për krime të cilat pretendohet se ai i kreu në funksionin si komandant/roje në kamp-burgun e Llapushnikut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) gjatë konfliktit midis serbëve etnikë dhe shqiptarëve në Kosovë më 1999. Konkretisht Bala u akuzua për përgjegjësi penale për kryerjen, urdhërimin ose ndryshe ndihmë dhe inkurajim në (i), burgim, tortura, veprime çnjerëzore dhe vrasje si krime kundër njerëzimit dhe (ii) trajtim mizor, tortura dhe vrasje si shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës.⁴ Bala u akuzua edhe për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, synimi i së cilës ishte frikësimi, burgimi, dhuna dhe vrasjet e civilëve serbë dhe shqiptarëve që konsideroheshin bashkëpunëtorë.⁵ Bala u arrestua më 17 shkurt 2003.⁶ Ai u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës.⁷

3. Më 30 nëntor 2005, Dhoma Gjyqësore II e Tribunalit (“Dhoma Gjyqësore”) e shpalli Balën fajtor në lidhje me tri pika; (i) torturim; (ii) trajtim mizor dhe (iii) vrasje si shkelje të

¹ IT/146/Rev.3, 16 shtator 2010

² *Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-I, Aktakuza, 24 janar 2003.

³ *Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-PT, Aktakuza e ndryshuar për Herë të Dytë, 6 nëntor 2003 (“Aktakuzë”). *Shih edhe Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-PT, Vendim për Miratimin e Ndryshimit të Aktakuzës, 25 mars 2003; *Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar; 12 shkurt 2004; *Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-PT, Korrigjim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë, 9 gusht 2004.

⁴ Aktakuza, para 21, 23-28, 31-37.

⁵ Aktakuza, para 3, 6-9, 12-13.

⁶ *Shih Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore”), para 737, 742.

⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 5; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, Kapitulli XII, Shtojca IV: Historia Procedurale, para 751.

ligjeve ose zakoneve të luftës. Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në rolin si roje në kamp-burgun e Llapushnikut, Bala kishte “ndihmuar në torturimin” e një të burgosuri, “keqtrajtoi personalisht” dhe ndihmoi në keqtrajtimin e të burgosurve të tjerë, luajti “rol personal në mbajtjen dhe imponimin e kushteve çnjerëzore të burgimit” në kamp dhe “mori pjesë personalisht në vrasjen e” nëntë të burgosurve.⁸

4. Dhoma Gjyqësore e dënoi Balën me 13 vjet burgim dhe, bazuar në Rregullën 101(c) të Rregullores periudha e kaluar në paraburgim iu llogarit si kohë burgimi.⁹ Më 27 shtator 2007, Dhoma e Apelit e hodhi poshtë në tërësi apelin e Balës dhe la në fuqi dënimin e dhënë nga Dhoma Gjyqësore.¹⁰

5. Më 7 shkurt 2008, Franca u caktua si vendi ku Bala do të vuante dënimin e tij.¹¹ Në maj 2008, Bala u transferua në Francë për kryerjen e pjesës së mbetur të dënimit të tij.¹²

6. Më 15 tetor 2010, Kryetari i atëhershëm Robinson e refuzoi kërkesën e Balës për ulje të dënimit duke cituar “provat shumë të kufizuara për rehabilitimin e tij dhe peshën e madhe të krimeve të tij”.¹³

[REDACTED]

II. KËRKESA

7. Bala e paraqiti këtë Kërkesë më 9 nëntor 2011, në bazë të paragrafit 2 të Direktivës që i lejon të dënuarit t'i paraqesin kërkesë drejtpërsëdrejti Kryetarit për lirim të parakohshëm. Kjo është kërkesa e parë e Balës për lirim të parakohshëm. Në kërkesë Bala argumenton se ai

⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 741.

⁹ Shih Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 742.

¹⁰ Shih Prokurori k .Fatmir Limajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-03-66-A, Aktgjykim, 27 shtator 2007, (“Aktgjykimi i Apelit”), Kapitulli VII, Vendim, f.116 (versioni anglisht)

¹¹ Shih Prokurori k .Fatmir Limajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-03-66-ES, Urdhër për Caktimin e Shtetit në të cilin Haradin Bala do të vuajë dënimin me burgim, 7 shkurt 2008 (bërë publik në bazë të Urdhrit që Shfuqizon Statusin Konfidencial të Urdhrit për Caktimin e Shtetit në të cilin Haradin Bala do të vuajë dënimin me burgim, 14 maj 2008), f. 2.

¹² Shih Prokurori k .Fatmir Limajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-03-66-ES, Urdhër që Shfuqizon Statusin Konfidencial të Urdhrit për Caktimin e Shtetit në të cilin Haradin Bala do të vuajë dënimin me burgim, 14 maj 2008.

¹³ Prokurori k .Fatmir Limajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-03-66-ES, Vendim mbi Kërkesën e Haradin Balës për Ulje të Dënimit, 15 tetor 2010 (“vendim mbi Ulje të Dënimit”), para 20.

kualifikohet për lirim të parakohshëm sepse ka kryer dy të tretat e dënimit si edhe për shkak të: (i) sjelljes së tij të mirë në burg dhe rehabilitimit të tij, sipas mendimit të Balës; (ii) trajtimit të personave në rrethana të ngjashme; dhe (iii) rrethanave të tij familjare dhe arsyeve të tjera humanitare.¹⁵ Në mbështetje të Kërkesës së tij, Bala parashtron një sërë dëshmish nga njerëz që i përkasin rrethit të tij, të cilat sipas tij provojnë aftësinë e tij për t'u riintegruar në ambientin e tij të mëparshëm pas lirimit.¹⁶

8. Më 14 nëntor 2011, Kryetari i atëhershëm Robinson e udhëzoi Sekretarin e Tribunalit (“Sekretari”) të kërkonte prej autoriteteve franceze dhe Zyrës së Prokurorit (“Prokuroria”) raportet dhe konstatimet përkatëse bazuar në shkronjat b dhe c të paragrafit 3 të Direktivës.¹⁷ Në përgjigje të kërkesës së Sekretarit, më 15 dhjetor 2011 Zyra e Prokurorit (“Prokuroria”) paraqiti një memorandum ku pohohej se Bala nuk kishte bashkëpunuar me Prokurorinë në asnjë fazë të gjykimit apo apelit të tij ose në procese të mëtejshme, por nuk përmendej nëse Prokuroria kishte kërkuar një bashkëpunim të tillë nga Bala.¹⁸

9. Më 18 prill 2012, ambasada e Francës në Holandë i dorëzoi Sekretarit të Tribunalit një notë verbale (“Nota Verbale”).¹⁹ Me anë të këtij dokumenti, autoritetet franceze rekomandojnë refuzimin e kërkesës së Balës kryesisht për arsye se: (i) nuk mund të ketë garanci mbi zbatimin nga qeveria e Kosovës të çfarëdo kushti shoqëruar lidhur me një lirim të parakohshëm të mundshëm, për shkak se Kosova nuk është palë e Konventës evropiane të viti 1964 mbi Mbikëqyrjen e Shkelësve të Dënuar me Kusht ose të Liruar me Kusht; dhe (ii) Bala ka bërë fare pak përparim në lidhje me pranimin e peshës së akteve të tij.²⁰ Notës Verbale ndër të tjera i bashkëngjiteshin një letër nga Ministria franceze e Drejtësisë;²¹ mendimi i Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së parë të Verdunit;²² mendimi i gjykatësit

¹⁴ *Shih Prokurori k .Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-ES, Vendim mbi Kërkesën e Haradin Balës për Transferim, 17 dhjetor 2010 (konfidencial) (“Vendim mbi Transferimin”), para 31.

¹⁵ Kërkesë, f 4-8.

¹⁶ Kërkesë, Shtojca A.

¹⁷ *Shih* Memorandum nga Kryetari, gjykatësi Robinson për Sekretarin, zotin John Hocking me datë 14 nëntor 2011, lënda-Kërkesë e Haradin Balës për Lirim të Parakohshëm.

¹⁸ *Shih* Memorandum nga Sekretari, z. John Hocking Robinson për Kryetarin, gjykatësin Theodor Meron me datë 22 mars 2012, *që përcjell* Memorandumin e Kryekëshilltarit Juridik të Prokurorit për Zyrën e Sekretarit me datë 15 dhjetor 2011 (“Memorandumi i Prokurorisë”, i bashkëngjitur si “Shtojca 1”).

¹⁹ *Shih* Memorandum nga Sekretari, z. John Hocking Robinson për Kryetarin, gjykatësin Theodor Meron me datë 10 mars 2012, *që përcjell* letrën e Ambasadës së Francës në Holandë për Zyrën e Sekretarit me datë 18 prill 2012, (bashkëngjitur si “Shtojca 2”).

²⁰ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 1, Letër e zëvendëssefit të Zyrës për Ndihmë Ndërkombëtare në Çështje Penale të Ministrisë së Drejtësisë së Francës për Tribunalin me datë 30 mars 2012.

²¹ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 1.

²² *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 3, me datë 20 mars 2012.

përmbarues të së njëjtës gjykatë;²³ aktekspertiza psikologjike për Balën nga z. François Leluc (“Aktekspertiza e Leluc-ut”);²⁴ aktekspertiza psikiatrike për Balën nga Dr. Hugues Collin (“Aktekspertiza e Collin-it”);²⁵ një letër nga Drejtoria e Administrimit të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë;²⁶ dhe një përmbledhje shoqërore dhe edukative nga i njëjti organ në lidhje me kushtet e burgimit të Balës në Qendrën e Burgimit në Montmédy²⁷ (së bashku, “Materiale Shtesë”).

10. [REDACTED]

[REDACTED]²⁸.

III. ANALIZË

11. Në marrjen e vendimit mbi Kërkesën dhe në përputhje me Rregullën 124 të Rregullores dhe paragrafin 6 të Direktivës, jam këshilluar me anëtarët e Byrosë, përkatësisht me zëvendëskryetarin dhe kryegjykatësit e Dhomave Gjyqësore të Tribunalit.²⁹

A. Ligji përkatës

12. Sipas Nenit 28 të Statutit, në qoftë se në bazë të ligjit në fuqi në shtetin ku i dënuari kryen burgimin, ai ose ajo kualifikohet për faljen ose uljen e dënimit, shteti përkatës njofton Tribunalin në lidhje me këtë fakt. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar, në konsultim me gjykatësit, vendos për çështjen në bazë të interesave të drejtësisë dhe të parimeve të përgjithshme të së drejtës.

²³ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 4, me datë 16 mars 2012.

²⁴ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 5, me datë 4 mars 2012.

²⁵ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 6, me datë 21 shkurt 2012.

²⁶ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 8, me datë 15 mars 2012.

²⁷ *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 9, me datë 16 janar 2012.

²⁸ *Shih Prokurori k .Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-ES, Përgjigje e Haradin Balës ndaj Parashtrimit të Autoriteteve Franceze mbi Kërkesën e tij për Lirim të Parakohshëm, dorëzuar më 1 qershor 2012 (“Përgjigje”) (konfidencial), para. 10.

²⁹ *Shih* Rregullën 25(a) të Rregullores. Megjithëse në bazë të Rregullës 124 të Rregullores duhej gjithashtu të këshillohesha me “cilindo gjykatës të përhershëm të Dhomës që dha dënimin, që është ende gjykatës i Tribunalit,” asnjë nga gjykatësit e përhershëm të Dhomës që vendosi dënimin e Balës nuk është më gjykatës i Tribunalit dhe si rrjedhojë për Kërkesën u këshillova vetëm me anëtarët e Byrosë.

13. Rregulla 125 e Rregullores parashtron se në përcaktimin e përshtatshmërisë së faljes ose uljes së dënimit, Kryetari merr parasysh, ndër të tjera, peshën e krimit apo të krimeve për të cilat është dënuar i burgosuri, trajtimin e të burgosurve në rrethana të ngjashme, prova të rehabilitimit nga ana e të burgosurit si dhe çfarëdo bashkëpunimi thelbësor të të burgosurit me Prokurorinë.

14. Paragrafi 2 i Neni 3 të Marrëveshjes Midis Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë së Republikës Franceze mbi Zbatimin e Dënimeve të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Marrëveshja e Zbatimit”), përcakton se kushtet e burgimit rregullohen prej ligjit francez me mbikëqyrjen e Tribunalit.³⁰ Paragrafi 4 i Neni 3 përcakton se në këshillim me gjykatësit e Tribunalit, Kryetari vendos nëse lirimi i parakohshëm është i përshtatshëm dhe Sekretari informon Francën në lidhje me vendimin e Kryetarit.³¹

15. Më poshtë do të analizoj secilin prej faktorëve të përmendur në Rregullën 125 të Rregullores si edhe faktorë të përmendur nga Bala në kërkesën e tij.

B. Kualifikohet për lirim të parakohshëm në bazë të ligjit francez

16. Në një nga dokumentet e bashkëngjitura Notës Verbale, Ministria franceze e Drejtësisë deklaroi se në bazë të Neni 729 të Kodit francez të Procedurës Penale, Bala kualifikohet për lirim me kusht për arsye se ai ka kryer më shumë se gjysmën e dënimit.³² Në fakt, sipas Neni 729 të Kodit të Procedurës Penale të Francës,

Lirimi me kusht mund të miratohet kur kohëzgjatja e pjesës së kryer të dënimit nga i dënuari është të paktën e barabartë me kohëzgjatjen e pjesës së mbetur të dënimit.

17. Deri më 13 qershor 2012, Bala ka qenë i burgosur për 9 vjet dhe 105 ditë, që do të thotë se ai ka kryer më shumë se gjysmën e dënimit të tij me 13 vjet dhe rrjedhimisht kualifikohet për lirim me kusht sipas Neni 729 të Kodit të Procedurës Penale të Francës.

³⁰ Marrëveshje Midis Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë së Republikës Franceze mbi Zbatimin e Dënimeve të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë me datë 25 shkurt 2000, Neni 3 (“Marrëveshja e Zbatimit”), neni 3(2).

³¹ Marrëveshja e Zbatimit, neni 3(4).

C. Pesha e Krimeve

18. Krimet për të cilat është dënuar Bala janë të rënda. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Bala “mori pjesë aktive në keqtrajtimin fizik të individëve të burgosur, qoftë si autor fizik apo si ndihmës.”³³ Dhoma Gjyqësore theksoi se “drejtimi i përditshëm i kamp-burgut prej tij çoi në kushte të këqija dhe çnjerëzore burgimi, veçanërisht në fllanik dhe ahur”.³⁴ Më i rëndë është përfundimi i Dhomës Gjyqësore për ekzekutimin e nëntë të burgosurve prej Balës. Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

Në ditën e fundit të burgosurit e mbetur u shoqëruan nga burgu nga Haradin Bala dhe nga një tjetër. Ka mundësi të ketë qenë edhe një rojë i tretë i UÇK-së. Pasi u çuan në malet e afërta të Berishës, disa të burgosur u liruan dhe u lejuan të largoheshin. Për të tjerët u vërtetua se nëntë prej tyre u ekzekutuan nga Haradin Bala dhe nga roja ose rojat e tjerë në bashkëveprim. Të paktën një i burgosur nuk u ekzekutua, por shumica e të burgosurve të mbetur vdiqën. Ky është aspekti më i rëndë i sjelljes kriminale të Haradin Balës.³⁵

Dhoma Gjyqësore shtoi se “kur Bala i çoi të burgosurit në malet, kur liroi disa prej tyre dhe kur ekzekutoi nëntë persona, ai veproi me urdhrin e një autoriteti më të lartë, identiteti i të cilit nuk është provuar nga dëshmitë” dhe se ai “nuk i vrau nëntë të burgosurit me nismën e vetë.”³⁶ Mirëpo vetëm ky përfundim nuk e pakëson peshën e krimeve të Balës.

19. Në kërkesën e tij, Bala nuk e vë në dyshim peshën e krimeve të tij, por argumenton se “ajo duhet parë në një rrafsh më të përgjithshëm, në mënyrë që përfundimi të mos rezultojë në trajtim të padrejtë të tij krahasuar” me të dënuar të tjerë të Tribunalit, krimet e të cilëve sikundër pretendon Bala “janë të krahasueshëm ose më të rëndë se krimet për të cilat është dënuar z. Bala.”³⁷ Ky argument nuk vlen sepse formulimi i Rregullës 125 të Rregullores nuk lejon krahasim të peshës së krimeve të kryera nga një person që kërkon falje ose lirim të parakohshëm. Sipas Rregullës 125 të Rregullores, “trajtimi i personave në rrethana të ngjashme” është faktor i ndryshëm që duhet shqyrtuar veçazi nga “pesha e krimeve”. Po të shqyrtohen në vetvete krimet e Balës janë të rënda dhe faktikisht pesha e tyre nuk pakësohet

³² *Shih* Shtojca 2, Notë verbale, Dokument 1, f. 2.

³³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 726.

³⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 726.

³⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 727.

³⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 727.

³⁷ Kërkesë, f. 6-7.

edhe po të krahasohen me krime të kryera nga të dënuar të tjerë të përmendur në Kërkesën e tij. Faktikisht asnjë nga nëntë personat e përmendur nga Bala nuk u dënuar për vrasje.³⁸

20. Mendimi im është se krimet e rënda të Balës përbëjnë një faktor kundër liritimit të tij të parakohshëm.

D. Trajtimi i Personave në Rrethana të Ngjashme

21. Sipas praktikës së Tribunalit, për lirim të parakohshëm kualifikohen të dënuarit që kanë kryer dy të tretat e dënimit.³⁹ Mirëpo theksoj se një i dënuar që ka kryer dy të tretat e dënimit thjesht *kualifikohet* për lirim të parakohshëm, por *nuk gëzon* të drejtën për një lirim të tillë.

22. Sikundër u përmend më sipër, që prej 13 qershor 2012, Bala ka qenë i burgosur për më shumë se 9 vjet dhe 105 ditë dhe rrjedhimisht ka kryer më shumë dy të tretat e dënimit të tij me 13 vjet. Duke marrë parasysh trajtimin e personave në rrethana të ngjashme, mendimi im është se kohëzgjatja e dënimit të kryer nga Bala shkon në favor të liritimit të tij të parakohshëm.

E. Prova të Rehabilitimit

23. Rregulla 125 e Rregullores përcakton se Kryetari merr parasysh prova të rehabilitimit të të burgosurit. Në lidhje me përcaktimin e rehabilitimit të të dënuarit, paragrafi 3(b) i Direktivës parashtron se Sekretari kërkon raporte dhe konstatime nga autoritetet përkatëse të shtetit përmbarues si për shembull mbi sjelljen e të burgosurit gjatë periudhës së burgimit dhe aktepsertiza psikiatrike ose psikologjike mbi gjendjen mendore dhe psikike të të dënuarit.

³⁸

[REDACTED]. *Shih Prokurori k. Dragan Obrenoviqit*, IT-02-60/2-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirim të Parakohshëm të Dragan Obrenoviqit, me datë 21 shtator 2011, para 14 (konfidencial) ([REDACTED])

[REDACTED]; *Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Lënda Nr. IT-00-39-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirim të Parakohshëm të Momçillo Krajishnikut, 26 korrik 2010, para 15 (“Nuk e gjykoj të përshtatshëm krahasimin e rrethanave të të dënuarve në këtë mënyrë sepse çdo kërkesë për lirim të parakohshëm duhet shqyrtuar në bazë të fakteve të çështjes”).

³⁹ *Shih për shembull Prokurori k. Vinko Marinkoviqit*, Lënda Nr. IT-08-34-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirim të Parakohshëm të Vinko Marinkoviqit, 16 dhjetor 2011, para 12; *Prokurori k. Dragan Zelenoviqit*, Lënda Nr. IT-96-23/2-ES, Vendim i Kryetarit mbi Kërkesën për Lirim të Parakohshëm të Dragan Zelenoviqit, 21 tetor 2011, para 15; *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Lënda nr. IT-04-84-R77.1-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirim të Parakohshëm të Shefqet Kabashit, 28 shtator 2011, para 13; *Prokurori k. Ivica Rajiqit*, Lënda nr. IT-05-12-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirim të Parakohshëm të Ivica Rajiqit, 22 gusht 2011, para 12; *Prokurori k. Millomir*

Autoritetet franceze kanë paraqitur raporte dhe konstatime të tilla të cilat i bashkëngjiten Notës Verbale (shih Shtojcën 2 të këtij Memorandumi).

24. Në Kërkesën e tij Bala përmend “sjelljen e mirë” në burg duke përfshirë “punën e tij në punëtorinë e burgut,” faktin se ai është “i sjellshëm dhe miqësor me të burgosurit e tjerë,” dhe përpjekjet e tij për “pjesëmarrjen në mësimet e gjuhës frënge dhe mësimin e gjuhës” dhe përgjithësisht për “vendosjen e kontakteve shoqërore dhe riintegruese.”⁴⁰ Autoritetet franceze pranojnë se Bala “është sjellë në mënyrë të kënaqshme gjatë burgimit,” për faktin se ai nuk është “përballur me procedim disiplinor [...] dhe se punon me përkushtim në vendin e punës”, duke demonstruar si pasojë aftësi “për riintegrim”.⁴¹

25. Mirëpo rehabilitimi nuk është vetëm sjellja e të burgosurit në burg apo rreziku i përsëritjes; ai gjithashtu ka të bëjë me qëndrimin e të burgosurit kundrejt akteve për të cilat është dënuar. Në lidhje me Balën ky aspekt anon kundër kërkesës së tij. [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED].⁴² [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED].⁴³

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED].⁴⁴ [REDACTED]

[REDACTED].⁴⁵ [REDACTED]

[REDACTED]

Stakiqit, Lënda nr. IT-97-24-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Millomir Stakiqit, 15 korrik 2011, para 22.

⁴⁰ Kërkesë, f. 5.

⁴¹ Mendimi i gjykatësit përmbareues të Gjykatës s1 Shkallës së Parë në Verdun, Shtojca 2, Notë Verbale, Dokument 4, me datë 16 mars 2011, f. 3. Shih edhe Pasqyrë shoqërore-arsimore nga Drejtoria e Administrimit të Burgjeve për Ministrinë e Drejtësisë së Francës, Shtojca 2, Notë Verbale, Dokument 9, me datë 16 janar 2012, f. 2 (ku theksohet se “që nga fillimi i burgimit në Qendrën e Burgimit Montmédy, z. Bala ka shfrytëzuar mundësitë që ofron burgju: shkollën, punën, dhe ka treguar sjellje korrekte”).

⁴² Përgjigje, para 1.

⁴³ Përgjigje, para 6.

⁴⁴ Aktekspertiza Leluc, f. 4.

⁴⁵ Aktekspertiza Leluc, f. 4.

[REDACTED]

⁴⁶

27. [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]

⁴⁷

[REDACTED]

⁴⁸

28. [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]

⁴⁹

⁵⁰

29. [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]

⁵¹

⁴⁶ Aktekspertiza Leluc, f. 5.
⁴⁷ Aktekspertiza Collin, f. 3
⁴⁸ Aktekspertiza Collin, f. 4
⁴⁹ Aktekspertiza Collin, f. 4; Aktekspertiza Leluc, f. 5.
⁵⁰ Aktekspertiza Leluc, f. 5.
⁵¹ Aktekspertiza Leluc, f. 5. *Shih edhe* Përgjigje, para 6.

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵²

30. [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵³ [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵⁴ [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵⁵ [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵⁶ [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵⁷ [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵⁸ [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] .⁵⁹

31. Bazuar në informacionin e deritanishëm dhënë Tribunalit, [REDACTED] përpjekjet e Balës për rehabilitim (të dëshmuara ndër të tjera përmes përpjekjeve të tij për të mësuar frëngjisht dhe punën e tij në punëtorinë e burgut) [REDACTED]

⁵² *Shih* Pasqyrë shoqërore-arsimore nga Drejtoria e Administrimit të Burgjeve për Ministrinë e Drejtësisë së Francës, Shtojca 2, Notë Verbale, Dokument 9, me datë 16 janar 2012 f. 2 ([REDACTED] [REDACTED]) Letër e zëvendës drejtorit të Administrimit të Burgjeve, me datë 15 mars 2012, Shtojca 2, Notë Verbale, Dokument 9 ([REDACTED] [REDACTED]), Shtojca 2, Notë Verbale, Dokument 1, f. 3.

⁵³ Vendim mbi Transferimin, para 20.

⁵⁴ Vendim mbi Transferimin, para 21.

⁵⁵ *Shih* Memorandum nga Kryetari, gjykatësi Robinson për Sekretarin, zotin John Hocking me datë 17 dhjetor 2011, lënda-Kushtet e Burgimit të Haradin Balës.

⁵⁶ *Shih* Letër e Sekretarit për Ambasadorin e Francës në Holandë, me datë 21 shkurt 2011.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty.

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED].⁶⁰ Pas analizës së kujdesshme të informacionit të lartpërmendur, kam mendimin se i njëjti konkluzion vlen edhe në rastin e Balës, d.m.th që faktori i rehabilitimit është neutral edhe në këtë rast.

F. Bashkëpunimi me Prokurorinë

32. Në Rregullën 125 të Rregullores përcaktohet se Kryetari merr parasysht çfarëdo bashkëpunimi thelbësor të të burgosurit me Prokurorin e Tribunalit. Në paragrafin 3(c) të Direktivës përcaktohet se Sekretari i kërkon Prokurorit paraqitjen e një raporti të hollësishëm të çfarëdo bashkëpunimi të të dënuarit me Zyrën e Prokurorit të Tribunalit dhe rëndësinë e këtij bashkëpunimi.

33. Në memorandumun për Sekretarin me datë 15 dhjetor (Shtojca I e bashkëngjitur), Prokuroria ka bërë të ditur se Bala nuk ka bashkëpunuar asnjëherë me Prokurorinë, si gjatë gjykimit po ashtu edhe gjatë apelit ose “gjatë kryerjes së dënimit”.⁶¹ Mirëpo theksoj se për të akuzuarin ose të dënuarin nuk ekziston detyrim për të bashkëpunuar në qoftë se nuk ka marrëveshje për pranimin e fajësisë. Gjithashtu nuk ekziston asnjë dokument që dëshmon se Prokuroria kërkoi bashkëpunimin e Balës në ndonjë fazë të procesit kundër tij apo pas dënimit të tij. Ne vendimin mbi uljen e dënimit, kryetari i atëhershëm Robinson theksoi se sipas raportit të paraqitur nga Prokuroria në përgjigje të kërkesës së mëparshme të Balës për ulje dënimi, Prokuroria “as kërkoi dhe as mori bashkëpunim nga” Bala.⁶² Nuk ekzistojnë prova shpresore se Prokuroria kërkoi bashkëpunim prej Balës që nga vendimi i vitit 2010 mbi uljen e dënimit.

⁵⁹ Shih më sipër shënim 53. Shih edhe Përgjigje, para 7 (ku argumentohet se “[REDACTED]”).

⁶⁰ Shih Prokurori k. Mllado Radiqit, Lënda Nr. IT-98-30/1-ES, Vendim i Kryetarit mbi Lirimin e Parakohshëm të Mllado Radiqit, para 16-26 (konfidencial).

⁶¹ Shih Shtojca 1, Memorandum i Prokurorisë, para 2.

⁶² Vendim mbi Ulje Dënimi, para 27.

34. Në Kërkesë, Bala parashtron se mosbashkëpunimi i tij me Prokurorinë duhet “të ketë efekt neutral në këtë çështje”.⁶³ E pranoj këtë parashtrim dhe nuk i kushtoj rëndësi këtij faktori.

G. Rrethanat Familjare dhe Faktorë Shtesë

35. Në paragrafin 8 të Direktivës përcaktohet se Kryetari mund të marrë parasysh çfarëdo informacioni tjetër që ai ose ajo beson se është i rëndësishëm në përmbushjen e kritereve të përkufizuara në Rregullën 125 të Rregullores.

36. Në kërkesën e tij Bala i kushton një vend të rëndësishëm rrethanave të tij familjare, sidomos “efektit negativ të mungesës së tij për familjen e tij të ngushtë”.⁶⁴ Burgimi i Balës faktikisht ka sjellë një barrë të rëndë për jetën familjare të tij, faktor që shkon në dobi të miratimit të lirimimit të parakohshëm.

H. Konkluzion

37. [REDACTED]

38. Pasi kam analizuar faktorët e identifikuar në Rregullën 125 të Rregullores, mendimin e kolegëve të mi dhe të gjithë informacionin e rëndësishëm të dokumentuar, pranoj se [REDACTED]

⁶³ Kërkesë, f. 9 *citohet* Vendim mbi Ulje Dënimi, para 27.

⁶⁴ Kërkesë, f. 8. Shih edhe Kërkesë, f. 8; Përgjigje, para 12-13.

39. Konstatohet se faktorët në favor të miratimit të kërkesës janë kryerja e dy të tretave të dënimit prej Balës që prej 12 qershorit 2012 dhe rrethanat e tij familjare. Natyrisht duhet përmendur se praktika e Tribunalit për shqyrtimin e kërkesave por lirim të parakohshëm pas kryerjes së dy të tretave të dënimit nuk do të thotë automatikisht se ata kanë të drejtë të lirohen. Gjithsesi dhe në përputhje me praktikën e njëtrajtshme të mëparshme të Tribunalit, kryerja e dy të tretave të dënimit nga i dënuari është faktor që peshon shumë në favor të lirimit të tij të parakohshëm. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh trajtimin e të burgosurve në rrethana të ngjashme dhe tërësinë e rrethanave në rastin e Balës, kam mendimin se kërkesa e Balës duhet miratuar megjithëse jo me efekt të menjëhershëm. Lirimi i parakohshëm i Balës duhet të shtyhet deri në fund të këtij viti kalendarik, d.m.th deri më 31 dhjetor 2012, me kusht që ai të vazhdojë të ketë sjellje të mirë si i burgosur dhe të mos merren masa disiplinore kundër tij gjatë kohës që ai kryen pjesën e mbetur të dënimit në Francë. Sekretari i Tribunalit duhet t'u kërkojë autoriteteve franceze që t'i paraqesin një raport lidhur me sjelljen e Balës më 1 dhjetor 2012 ose mundësisht pas kësaj date në mënyrë që unë të mund të përcaktoj nëse Bala e ka përmbushur kushtin e sjelljes së mirë në rast se lirohet. Në qoftë se nuk paraqitet raport, ose në rast se në raportin e tyre autoritetet franceze nuk ngrenë kundërshtime ndaj lirimit të Balës bazuar në sjelljen e tij, atëherë Bala të lirohet më 31 dhjetor 2012. Këto kushte dhe fakti se deri më 31 dhjetor 2012, Bala do të ketë kryer thujse 10 vjet nga dënimi i tij prej 13 vjetësh janë të mjaftueshëm për t'iu përgjigjur shqetësimeve të kolegëve të mi mbi mungesën e rehabilitimit të Balës.

IV. VENDIM

40. Për arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me Nenin 8 të Statutit, Rregullat 124 dhe 125 të Rregullores, paragrafin 8 të Direktivës dhe Nenin 8 të Marrëveshjes së Zbatimit, MIRATOHET lirimi i parakohshëm i Balës që hyn në fuqi më 31 dhjetor 2012.

41. UDHËZOHJ Sekretarin që të informojë autoritetet franceze mbi këtë vendim sa më shpejt që të jetë e realizueshme sikundër parashkruhet në paragrafin 11 të Direktivës dhe gjithashtu t'u kërkojë autoriteteve franceze që t'i paraqesin Sekretarit të Tribunalit një raport mbi sjelljen e Balës më 1 dhjetor 2012 ose mundësisht pas kësaj date në mënyrë që unë të mund të përcaktoj nëse Bala e ka përmbushur kushtin e sjelljes së mirë në rast se lirohet. Në qoftë se nuk paraqitet raport, ose në rast se në raportin e tyre autoritetet franceze nuk ngrenë kundërshtime ndaj lirimit të Balës bazuar në sjelljen e tij, atëherë Bala të lirohet më 31 dhjetor 2012.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Theodor Meron
Kryetar

Sot, më 9 janar 2013.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]